




REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01 Nr. 118-20142

Më: 15-04-2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13, 58, 62.4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, kërkesës së Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjakovë me nr. zyrtar 04/1688/ i dt.13/04/2016, neni 11 paragrafi 1, paragrafi 2 pika 2.3 dhe neni 3 të Rregullores Nr.01/2011 Për Ndërrorjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil të dt.21/03/2011, Udhëzimit Administrativ nr.32/2014 Për Kriteret dhe Procedurat Për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional – Proceset e Brendshme i dt.05/09/2014 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, merr këtë:

V E N D I M

1.z.Adem Musliu, nga Gjakova, Komuna e Gjakovës, nga data 30.04.2016 i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të tejkalimit të afatit kohor të Vendimit 01 Nr.07/2012 i dt.06/02/2012 si drejtor i shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë dhe i njëjti ricaktohet si koordinator i sigurimit të cilësisë pranë kësaj shkolle deri në arritjen e moshës së pensionimit.
2.Autorizohet shërbimi financiar pranë Drejtorisë për Arsim që të ndaloj pagesën e të ardhurave personale në lartësi të koeficientit të paraparë për pozitën e drejtorit të shkollës dhe i njëjtit t'i llogariten të ardhurat personale në lartësi të koeficientit 6.36 të paraparë për pozitën e mësimdhënësit/koordinatorit të sigurimit të cilësisë.

A r s y e t i m

z.Adem Musliu, nga data 30/04/2016, i ndërpritet marrëdhënia e punës si drejtor pranë kësaj shkolle për shkak të tejkalimit të afatit kohor të Vendimit 01 Nr.07/2012 i dt.06/02/2012 si drejtor i shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë.
Të ardhurat personale mujore për vendin e punës si drejtor të ndërpritet nga data 30/04/2016 dhe të njëjtit t'i llogariten të ardhurat personale në lartësi të koeficientit 6.36 të paraparë për pozitën e mësimdhënësit/koordinatorit të cilësisë deri në arritjen e moshës së pensionimit.
Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet :

- z.Adem Musliu
- Shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë
- Drejtorisë së Arsimit
- Zyrës së Personelit
- Shërbimit të pagesave
- Arkivit

KRYETARJA,

Znj.Mimoza Kusari Lila

